



| | | | | |
|--|-------------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------------|---------------------|
| Pranimi / Dorezimi / Prilipimi / Podalo / Received / Delivered | 23 - 11 | 2023 | 3 | viti god Year |
| Organ / Shkëmbim / Organ / Jednitsa / Org / Unit | Nr. Prot / Br. Prot / Prot No | Shtojra / Prilog / Appendix | Sasia / Kolicina / Quantity | |
| SKINSHUK | 7079 | 2023 | 112 | |



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1301/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë; me Ilire Mehmeti-Shaqiri Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.1301/2023, të datës 19.10.2023, të parashtruar nga ankuesi Komuna e Suharekës, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik, në çështjen juridike „shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.8; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.11.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1301/2023, të datës 19.10.2023, të parashtruar nga ankuesi

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit për Ankesa në Komunën e Suharekës.

A r s y e t i m

Ankuesi (me tej referuar vetëm ankuesi), me datë 16.10.2023 përmes Postës së Kosovës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 19.10.2023 dhe e regjistruar nën shenjën A.nr.1301/2023, me pretendimet ankimore se kategorizimi i ankueses nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë nga koeficienti 6.5 në koeficientin 3.94, është jo ligjor dhe në kundërshtim me të gjitha parimet nga marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi në bazë të Akt emërimit me numër 01- Nr-128 , të datës 28.10.2011, mbanë pozitën e punës “Kinooperator” në Shtëpinë e Kulturës, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Suharekës.

Me dispozitat e Ligjit NR. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë i aplikueshëm nga data 26.09.2023, përkatësisht me nenin 5 të këtij ligji, është përcaktuar se: “...Kategoritë e zyrtares/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit..... . 2.Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo

zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunëse/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunëse/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë., 5. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës është zyrtarja/i publik që kryen veprimtari ndihmëse të mirëmbajtjes, të ruajtjes, të vozitjes dhe veprimtari të ngjashme në institucionet publike” rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës për pozitën “ Konooperator” citojmë: “ - Mirëmbajtja e Shtëpisë së Kulturës; - mirëmbajtja e aparaturave të zërimit dhe të videobimit; - përkujdeset e zhvillimit të aktiviteteve të kulturës në nivel komunal;- kujdeset për zërimin gjatë mansifestimeve të ndryshme të komunës, drejtorive dhe shkollave, kryen edhe punë tjera të cilat ja cakton Drejtori; Kolegji i Këshillit vlerëson së pozita “Kinooperator”, pozitë të cilën ankuesi e ushtron, hynë në kategorinë e nëpunësve teknik dhe mbështetës. Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për praninë në Shërbimin Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1301/2023 të datës 19.10.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji duke u bazuar në nenin 95 paragrafi 2 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenin 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, konstaton se nëpunësit **teknik dhe mbështetës**, fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Komunën e Suharekës.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1301/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesi
- Komisionit për Ankesa në Komunën e Suharekës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Suharekës;
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

